

**XHOSH MEK-DAUELL
dhe
SHON MEK-DAUELL**



**RINGJALLJA
dhe TI**

**Botim i Institutit "Jeta e Re"
www.ijr.al**

RINGJALLJA DHE TI

RINGJALLJA DHE TI

XHOSH MEK-DAUELL dhe SHON MEK-DAUELL

Përktheu: Elvana Kurti

Korrektoi & Redaktoi: Elmira Mjeshtri & Agesil Qiriaz

Titulli në origjinal: The Resurrection and You.

© Josh McDowell Ministries, a ministry of CRU, a California non-profit religious corporation. 2001 West Plano Parkway, Suite 2400, Plano, TX 75075, USA.

Botuar në Anglisht nga BakerBooks, a division of Baker Publishing Group, P.O. BOX 6287, Grand Rapids, MI, 49516

© Për Botimin në shqip: IJR Botimet

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk duhet të riprodhohet, të vihet në një sistem ose të transmetohet në çdo formë apo mënyrë (elektronike, fotokopje, incizim, apo në ndonjë mënyrë tjetër) pa marrë më parë leje me shkrim nga botuesit.

Na kontaktoni:

Instituti Jeta e Re, Email: info@ijr.al

Përmbajtja

Një përjetim personal: Çfarë ndodhi kur u nisa të hidhja poshtë krishterimin – Nga Xhosh Mek-Dauell fq. 4.

1. Pse ka rëndësi ringjallja: Shpresa e vetme për botën fq. 7
2. A mund ta dimë se ringjallja ka ndodhur? A është e vërtetë? A është e besueshme? fq. 15
3. Provat për ringjalljen: A vdiq, u varros dhe u ringjall Jezusi? fq. 24
4. Çfarë vjen më pas? fq. 38

Shënime fq. 41

Një përjetim personal

Çfarë ndodhi kur u nisa të hidhja poshtë krishterimin

XHOSH MEK-DAUELL

Si student i Kolegjit “Kellog”^a, po përgatitesha të vazhdoja studimet për juridik dhe më pas t’i futesha politikës. Nga gjithë studentët e atyshëm, më ra në sy një grup studentësh që jetonin ndryshe. Në vend që të jetonin për paranë, suksesin apo famën, këta studentë e donin me të vërtetë njëri-tjetrin. Unë vija nga një familje me probleme, ku isha përdhunuar nga punëtori i fermës sonë, Uejn Bejli, çdo javë, për shtatë vjet. Ndaj thellë në shpirt e dëshiroja fort atë dashuri që ata dukej se përjetonin dhe e shfaqnin me

^a *Kellogg College*, është pjesë e Universitetit të Oksfordit në Angli, në nivelin master. Është themeluar më 1 mars 1990 dhe, në vitin 1994, mori emrin *Kellogg College*, në nderim të *Will Keith Kellogg*, si shenjë mirënjohjeje për mbështetjen që i dha universitetit **Fondacioni W. K. Kellog**. Ofron studime në mjekësi, arsim, jurisprudencë, shkencë kompjuterike etj. Është një kolegji që ka studentë nga shumë vende të botës. (*Shënim i redaktorit. Po ashtu janë edhe të gjitha shënimet me shkronja, kurse shënimet me numra janë të autorëve.)

sinqeritet. Dashuria e tyre për të gjithë njerëzit, si për ata brenda, dhe për ata jashtë grupit të tyre, më dukej e çuditshme. Po thellë në shpirt e dëshiroja shumë ta kisha edhe unë.

Por unë isha edhe një skeptik i pasigurt, që s'më pushonte goja. Nuk doja që ata të merrnin vesh lëndimin dhe dhimbjen që kisha thellë në zemër. Dhe s'kisha qejf që ta merrnin vesh se sa fort po kërkoja kuptim dhe qëllim për jetën time. Me shpresën se do ta zbuloja sekretin e tyre, i bëra shokë. Një ditë, ndërsa u ulëm rreth një tavoline në "Unionin Studentor", pyeta njëren nga vajzat e grupit se pse ishte aq ndryshe nga studentët dhe profesorët e tjerë të qendrës universitare. U përpoqa të shtiresha sikur e bëra pyetjen sa për të thënë, por *vërtet* doja ta dija. Ajo buzëqeshi ëmbël, u kthye nga unë dhe, si pjesë të përgjigjes, më tha dy fjalë që kurrë s'ma kishte marrë mendja t'i dëgjoja në një qendër universitare. Ajo tha vetëm: "Jezu Krishti."

Ia ktheva menjëherë: "Mos më trego këto budallallëqet për fenë. Më ka ardhur në majë të hundës me fenë, kishën dhe Biblën." Vajza kishte bindje të forta, sepse menjëherë m'u kthye: "Zotëri, nuk të thashë feja. Të thashë personi i Jezu Krishtit." Nuk kisha qëllim ta fyeja, ndaj i kërkoja ndjesë që shpërtheva ashtu. Por unë mendoja se të krishterët ishin dështakë, dhe nuk e honepsja fenë; më lodhte. Si mundet dikush, që vdiq dy mijë vjet më parë, të ketë të bëjë me jetën time sot?

Për habinë time, grupi më sfidoi që t'i shqyrtoja pohimet e Krishtit. Ata më sfiduan të analizoja provat historike për Shkrimet, për hyjninë e Krishtit dhe për ringjalljen e Jezusit. Sinqerisht e mora si shaka! Dhe e kisha ndarë mendjen t'ua provoja që e kishin gabim. Ndaj u largova nga universiteti dhe, me paratë që kisha kursyer nga një biznes i suksesshëm si bojaxhi, udhëtova nëpër Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli dhe në Lindjen e Mesme, për të mbledhur prova që do ta hidhnin poshtë krishterimin. Sot, shumë nga këto prova mund të gjenden nëpër libra, në bibliotekat lokale dhe në internet. Por, në 1950-n, origjinalet mund t'i shihje vetëm në biblioteka dhe universitete nëpër botë. U nisa që të tallesha intelektualisht me krishterimin. Ajo që zbulova e ndryshoi krejt jetën time.

Një të premtë mbasdite vonë, isha ulur vetëm në një bibliotekë në Londër, në Angli, i kapitur pas muajsh të tërë kërkimesh. Papritur dëgjova një si zë që më foli. Normalisht nuk para dëgjoj zëra, ndaj u shokova dhe u

RINGJALLJA DHE TI

turbullova shumë. Ai zë më tha: *Xhosh, t'i nuk ke as edhe një provë ku të kapesh.* Ia zura menjëherë gojën këtij zëri. Në fund të fundit qëllimi im ishte të *hidhja poshtë* krishterimin, jo ta besoja atë. Është interesante që pothuaj çdo ditë tjetër pas asaj dite dëgjova të njëjtin zë, por më të fortë, më të fortë dhe akoma më të fortë! Sa më shumë i analizoja provat, aq më tepër më bënë të arrija në përfundimin e kundërt të asaj që doja të provoja.

Kisha qëllim të hidhja poshtë krishterimin, por puna kërkimore më bëri të arrija në përfundimin që unë mund t'i besoja Biblës se Jezusi është Perëndi, dhe se Ai u ringjall nga të vdekurit në ditën e tretë.

Edhe pse e dija që gjithçka që e vërtetë, në fillim nuk desha t'ia përkushtoj jetën ndjekjes së Jezusit. Kisha frikë nga ajo që do të mendonin njerëzit për mua dhe nga kostoja e të qenit besimtar. Por tani, pas pesë dekadash që ndjek Krishtin, mund ta them me gjithë zemër se ishte vendimi më i mirë i jetës sime. Provat më tërhoqën vëmendjen, por ishte dashuria e Perëndisë, të cilën e pashë të shfaqur në jetët e atyre studentëve në fillim të udhëtimit tim, ajo që më pushtoi zemrën përfundimisht.

Ringjallja dhe ti është një libër, të cilin, im bir, Shoni, dhe unë, e kemi shkruar së bashku. Nëse je besimtar, shpresojmë që ky libër të të japë disa prova, të cilat do të të ndihmojnë të kuptosh se besimi yt është i mbështetur mbi themele të forta. Nëse je dakord, mendo që t'ia japësh këtë libër ndonjë shoku që nuk është i krishterë?

Nëse je skeptik, e vetmja gjë që të kërkojmë është ta lexosh këtë libër me mendje të hapur. Nëse Jezusi u ringjall vërtet nga të vdekurit, duke vërtetuar kështu që Ai është Perëndi (Romakëve 1:4), atëherë s'ka asgjë më të rëndësishme në jetë sesa të ndjekësh Atë. Nëse Jezusi nuk u ringjall nga të vdekurit, atëherë ti nuk ke asgjë për të humbur. E gjitha është veç një shaka e keqe.

Askush nuk e ka ndryshuar botën më shumë sesa Jezu Krishti. Dhe Ai akoma ndryshon jetë edhe sot. Tani, le të shqyrtojmë provat për ringjalljen dhe se çdo të thotë kjo për jetën *tënde*.

PSE KA RËNDËSI RINGJALLJA

Shpresa e vetme për botën

Shikoni këtë koment që postoi një vajzë në një faqe interneti ateiste:

“Jam e pështjelluar... Kam besuar gjithnjë se shkenca do të ishte zgjidhja për të gjitha problemet e mia, por nuk e di a mund të vazhdoj të jetoj pa jetë të përjetshme. Ma merr mendja që do më duhet të gjej vetë një rrugë për t’ia dalë në këtë jetë pa kuptim. Ah, sikur të dija ku të gjeja dikë që të mund më tregonte rrugën drejt jetës së përjetshme. Po nëse shkenca nuk mund t’i japë përgjigjet, atëherë kush ose cila është ajo gjë që mundet!? *psherëtimë* A nuk duket sikur ka një fuqi më të lartë që u jep qëllim jetëve tona? Epo, shkenca thotë që nuk ka, ndaj s’ka.”¹

A jeni ndier ndonjëherë si kjo vajza? E keni provuar dhe ju të njëjtin ankth? A e keni bërë ndonjëherë pyetjen: A ka kuptim, në fund të fundit, në

një univers ateist? Edhe filozofi i madh e i njohur Bertrand Rasëll, e kuptoi që një univers ateist është pa kuptim.²

Shpresa është me pikatore në kulturën tonë këto ditë. Nëse jeta, siç duket tani në këtë planet të mbushur me dhimbje, është vetëm kjo që është, atëherë ekzistenca në të vërtetë është e pakuptimtë dhe njeriu duhet, siç thotë kjo vajza, “të gjejë vetë një rrugë.” Ajo e kupton që ka diçka që do ta bëjë çdo gjë të ketë kuptim: *jeta e përjetshme*. Ka qenë një kohë kur ajo priste që shkenca të gjente një mënyrë që njerëzit të jetonin përgjithmonë, por ajo e ka kuptuar që shkenca s’e bën dot këtë.

Në një periudhë të historisë, ishte një grup njerëzish që e vendosën besimin e tyre te dikush për të cilin besonin me zjarr se Ai me të vërtetë do të ndryshonte botën për mirë. Një dorë hebrenjsh të përkushtuar menduan se një njeri që quhej Jezu, ishte Mesia - çliruesi që do të thyente zinxhirët e skllavërisë shtypëse të Perandorisë Romake dhe do të vendoste një mbretëri të përhershme e vërtetë të perëndishme në tokë. Profeti i tyre, Isaia, kishte profetizuar në shkrimet e lashta hebraike se Mesia do të vinte dhe do t’i rregullonte të gjitha gjërat, duke e bërë gjithçka parajsë, ku nuk do të kishte më luftra, shtypje, frikë apo vdekje (Isaia 11:35). Të gjithë do të jetonin së bashku në paqe, përgjithmonë.

Përfytyroni gjendjen e tmerrshme mendore dhe emocionale të këtij grupi të vogël ndjekësish, ndërsa rrinin dhe e shikonin Mesinë, shpëtimtarin e tyre, duke dhënë frymën e fundit në agoni, i varur në një kryq romak, për të vdekur si kriminel ordiner. Kishin hequr dorë nga çdo gjë, për ta ndjekur. Por tani, ja ku ishte Ai, i gozhduar në kryq. Po vdiste! Dhe bashkë me Të po vdisnin të gjitha shpresat që ata kishin vendosur tek Ai. Ata duhet të jenë ndier si ajo vajza, të cilën e cituam më lart. Jeta dukej pa kuptim. Çdo gjë ishte e pashpresë. Nuk dukej sikur kishte një rrugë shpëtimi për ekzistencën e tyre absurde, asnjë shteg drejt një jete të përjetshme ideale.

Maria Magdalena ishte një nga këta ndjekës të Jezusit, Mesisë. Ajo e mbështeti financiarisht shërbesën e Tij dhe besoi se Jezusi ishte Ai që Perëndia kishte zgjedhur për të sjellë paqe të përjetshme në botë. Ajo qëndroi pranë kryqit dhe ishte dëshmitare e ekzekutimit mizor të mësuesit të saj, dhe tani jeta e saj ishte një kaos i vërtetë.

Pasi ushtarët romakë u bindën se Jezusi kishte vdekur, e zbritën trupin nga kryqi dhe ia dhanë një zyrtari të pasur hebre, që ta varroste në një varr të ri. Maria u largua nga ajo skenë e zymtë, e vendosur që të shkonte te varri i Tij, pasi të ishte varrosur. Ajo shkoi te varri të dielën në mëngjes herët, dhe

RINGJALLJA DHE TI

atje përjetoi një tjetër zhgënjim. Jezusin jo vetëm që e kishin vrarë padrejtësisht, por tani varri ishte i hapur dhe trupi i Tij ishte zhdukur. Kjo e tmerroi. E trembur nga ideja që dikush kishte vjedhur trupin, ajo vrapoi te Pjetri dhe Gjoni, dy nga ndjekësit e Jezusit, dhe u tregoi atë që kishte parë. Të dy burrat, në mosbesim të plotë, vrapuan me të shpejtë drejt varrit, për ta parë me sytë e tyre atë që u tregoi ajo.

Kur arritën, panë pëlhurën prej liri të të vdekurit të paprekur, ndërsa trupi nuk ishte. Të frikësuar dhe të pështjelluar, dy dishepujt u kthyen në shtëpi. Por Maria qëndroi edhe ca. Ajo pa edhe njëherë me vëmendje brenda varrit dhe u trondit nga ajo që pa: brenda në varr qëndronin dy burra të veshur me rroba të bardha të shndritshme.

“O grua, pse po qan?” - e pyetën engjëjt.

“Sepse e kanë hequr Zotin tim,” - u përgjigj ajo - “dhe nuk e di ku e kanë vënë” (Gjoni 20:13).

Kur u kthye prapa, pa diçka edhe më të jashtëzakonshme: Jezusi po qëndronte në këmbë, përpara saj, i gjallë! Por, çuditërisht, në vend që ta njihte, ajo kujtoi se ishte kopshtari. Jezusi i bëri asaj të njëjtën pyetje që i kishin bërë dhe engjëjt:

“O grua, pse po qan?”

Akoma pa e ditur se kujt po i fliste, ajo i tha butësisht:

“Zot, po e pate hequr ti, më thuaj ku e vure dhe unë do ta marr” (v.15).

Por pastaj, në një moment dhembshurie të jashtëzakonshme, Jezusi e thërriti atë në emër: “Mari!” - i thirri Ai.

“Rabboni!”^b - thirri ajo, dhe e njohu menjëherë. (v.16)

Jezusi qëndronte i gjallë para Marisë, gëzonte shëndet të plotë dhe dukej mirë, sepse vdekja nuk mund ta mbante Mesinë e premtuar. Perëndia e ka ringjallur që Ai të përmbushë misionin e Tij dhe t'i sjellë jetë të përjetshme një bote të sëmurë dhe të vdekshme.

^b Mësues.

Shpresa që kemi në ringjalljen

Kur Krishti ishte në kryq, u duk sikur gjithçka mori fund. Vdekja kishte fituar. Por, pas tri ditësh në varrin e një të pasuri, Jezusi u shfaq përsëri i gjallë. Lajmi ishte kaq tronditës, sa që ndjekësit e Tij nuk arrinin ta besonin, derisa Ai iu shfaq atyre fizikisht dhe i ftoi të shihnin me sytë e tyre shenjat e gozhdëve në duart dhe këmbët e Tija. Pastaj Jezusi u tha diçka të mahnitshme dishepujve: në të ardhmen edhe ata do të kishin trupa të ringjallur si i Tiji, trupa që nuk do të prisheshin kurrë, nuk do të vjetëroheshin apo nuk do të vdisnin. Ata do të shihnin të realizuar atë shpresë të madhe që do t'i jepte kuptim një ekzistence, e cila përndryshe ishte e pakuptimtë. Ata do të kishin jetë të re, pa vdekje apo dhimbje, përgjithmonë, në praninë e një Perëndie të dashur.

Kjo është shpresa e madhe që i ofron krishterimi një bote të pashpresë - një jetë me Perëndinë, pas vdekjes, pa dhimbje e vuajtje, dhe të mbushur me gëzim pa kufi. Pavarësisht se çfarë thonë shumë kritikë, besimi në ringjalljen nuk na bën "tokësorë jo të mirë". Në të vërtetë, na jep shpresë për të ardhmen dhe ndikon në mënyrën se si i trajtojmë njerëzit dhe krijimin në të tashmen. Ky besim në jetën e përjetshme nuk është thjesht ëndrra në diell, sajuar për të na bërë të ndihemi mirë në një botë të pashpresë; është një besim i vendosur në prova me themele të forta. Në këtë libërth do t'i shqyrtojmë këto prova të shumta.

Rëndësia jetike e ringjalljes

Fakti historik i ringjalljes është vetë themeli i besimit të krishterë. Nuk është një element i mundshëm i besimit - është *besimi!* Ringjallja e Jezu Krishtit dhe krishterimi qëndrojnë ose rrëzohen bashkë. Nuk mundet që njëra të jetë e vërtetë pa tjetrën. Besimi në të vërtetën e krishterimit nuk është thjesht besim në besim - në besimin tonë apo të dikujt tjetër - por është besim në Krishtin e ringjallur të historisë. Pa ringjalljen historike të Krishtit, besimi i krishterë ka thjesht efektin placebo^c. Pa ringjalljen fizike në kuptim të drejtpërdrejtë, mund edhe ta harrojmë Perëndinë, kishën dhe ndjekjen e rregullave morale. Ne

^c Në psikologji dhe mjekësi njihet si një mënyrë për t'i bërë njerëzit të ndihen më mirë se ç'janë në të vërtetë.

RINGJALLJA DHE TI

mund edhe vetëm “të hamë e të pimë, sepse nesër do të vdesim!” (1 Korintasve 15:32).

Nga ana tjetër, nëse Krishti është ringjallur nga të vdekurit, atëherë Ai është i gjallë në këtë moment (1 Korintasve 15:4) dhe ne mund ta njohim Atë personalisht. Mëkatet tona janë falur (v.3) dhe Ai e ka shkatërruar fuqinë e vdekjes (v.54). Për më tepër, edhe ne do të ringjallemi një ditë (v.22). Ne mund t’i besojmë Atij, sepse Ai është sovran në botë (v.27). Ai do të na japë fitoren përfundimtare (v.57) dhe një jetë me kuptim (v.58).

Studiuesi britanik N. T. Rajt shpjegon se sa thelbësore ka qenë ringjallja në jetën e kishës:

Nuk ka një formë të hershme të krishterimit, të njohur për ne - ndonëse janë disa të tilla që janë shpikur nga studiues mendjehollë - që në thelb të tyre nuk pohojnë se pas vdekjes së turpshme të Jezusit, Perëndia e ringjalli atë përsëri. Pothuaj në kohën e Palit, kur kemi edhe të dhënat e shkruara më të hershme, ringjallja e Jezusit nuk është vetëm një element besimi i shkëputur. Ringjallja është endur në thelb të strukturës së jetës dhe mendimeve të krishtera.³

Ndonëse ringjallja e Jezusit është shumë më *tepër* sesa një fakt historik, nuk është asgjë më *pak* sesa një fakt i tillë. Më pas do të tregojmë që ka prova të fuqishme, të verifikuara, që ringjallja ndodhi me të vërtetë.

Kuptimi personal i ringjalljes

Liri nga frika e vdekjes

Është normale që njerëzit të kenë frikë nga vdekja. Jo vetëm që është jashtëzakonisht e vështirë ta përfytyrosh që nuk do të ekzistosh më, por është edhe e tmerrshme.

Pse kemi pikërisht frikë nga vdekja? Po japim gjashtë arsye:⁴

1. Vdekja është misterioze dhe e panjohur.
2. Me vdekjen duhet të përballemi të vetëm.
3. Ndahemi nga njerëzit tanë të dashur.

4. Shpresat dhe ëndrrat tona personale nuk do të realizohen.
5. Vdekja rrit mundësinë që ne të zhdukemi krejt.
6. Vdekja është e pashmangshme.

Ndonëse Bibla nuk premtonte asnjëherë çlirim të plotë nga pikëpamja e vështirë emocionale e vdekjes, na thuhet që fitorja mbi frikën plotësisht paralizuese të saj është në dorën tonë. Të kuptuarit me të vërtetë të doktrinës biblike të ringjalljes, na çliron nga frika ligështuese për udhëtimin tonë të fundit brenda një bote të panjohur.

Ringjallja e bën të qartë që, pavarësisht se sa dërrmuese janë përpjekjet, zhgënjimet dhe telashet tona, ato janë vetëm të përkohshme. Pavarësisht se çfarë ndodh me ty, pavarësisht se sa e madhe është tragjedia apo dhimbja me të cilën përballësh, pavarësisht se si të ndjek vdekja ty dhe të dashurit e tu, ringjallja premtonte një të ardhme tej mase të mirë.

Realizimi i shpresave dhe dëshirave tona

Shkrimtari fantastiko-shkencor Isak Asimov shprehu qëndrimin që shumë njerëz kanë për parajsën, kur shkroi: “Unë nuk besoj në jetën pas vdekjes, prandaj nuk më duhet të kaloj gjithë jetën time duke patur frikë nga ferri apo nga parajsa. Pasi, sido që të jenë torturat e ferrit, mendoj që parajsa do të jetë e mërzitshme, dhe kjo do jetë edhe më keq.”⁵

Është e trishtueshme që edhe midis të krishterëve ka një ide të ngjashme për jetën pas vdekjes. Vizioni ynë për parajsën shpesh kufizohet në një shërbesë kishtarë të gjatë, të mërzitshme dhe jofrymëzuese. Ose, shumë njerëz, të ndikuar nga filmat vizatimorë dhe barsaletat, e shohin atë si një vend ku ne do të endemi kot nëpër re, të veshur me rroba të gjata të bardha, ndërsa u biem harpave si mos më keq. Në një farë mënyre, përfytyrimi ynë për parajsën është shtrembëruar në mënyrë groteske dhe pikëpamja e jetës pas vdekjes nuk e ka pushtuar imagjinatën tonë apo nuk e ka transformuar jetën tonë.

Unë, Shoni, i pyeta kohët e fundit studentët e mi se çfarë do të bënin ata, nëse do të kishin vetëm tri ditë jetë, përpara se të vdisnin dhe të shkonin në parajsë. Si do t'i kalonin ato pak ditë? Përgjigjet ishin: hedhje me

parashutë, udhëtim, sërif, dhe (sigurisht) të bënin seks. E vazhdova me një pyetje të thjeshtë: “Pra, ju mendoni që mund të ketë kënaqësi dhe përvoja në këtë jetë, të cilat, nëse nuk i bëni përpara se të vdisni, e humbët rastin njëherë e përgjithmonë për t’i provuar, sepse ato nuk do të ekzistojnë në parajsë?” Me përjashtim të dy studentëve, të gjithë të tjerët thanë po. Pamja e parajsës i frikësonte dhe i zhgënjente.

Mungesa e perspektivës së përjetshme i dekurajon njerëzit, i çon në mëkat. Shumë prej tyre mendojnë që, nëse nuk i provojnë disa kënaqësi tani, e humbin rastin përgjithnjë dhe nuk do t’i përjetojnë kurrë më këto gjëra. Ata mbajnë këtë qëndrim, sepse në mendjet e tyre kanë një pamje të gabuar për atë që është në të vërtetë parajsja.

Ne jemi mësuar që shumë shpesh t’i përshkruajmë në mënyrë shpirtërore qiejt e rinj dhe tokën e re me një interpretim jofizik. Shpesh, kur njerëzit e quajnë diçka shpirtërore, ata duan të thonë jofizike. Kjo ka sjellë një konceptim të gabuar dhe jep idenë që krijimi fizik i Perëndisë është në njëfarë mënyre inferior ndaj gjërave shpirtërore të vërteta, përfshirë dhe parajsën. Shumë njerëz, gjithashtu, besojnë se ne do të jemi qenie shpirtërore në parajsë, që për ta do të thotë se do të jemi pa trupa të vërtetë fizikë, solidë e të dukshëm. Kjo ide çon në një ndarje jobiblike ndërmjet fizikes dhe shpirtërores, duke bërë që shumë njerëz të mendojnë se vetëm shpirtërorja është e mirë dhe fizikja është e përkohshme, e asgjësueshme, madje, në disa mënyra, e keqe.

Një ide e tillë ka probleme serioze. Njerëzit që besojnë kështu, kanë prirjen të harrojnë që në fund të çdo dite të krijimit fizik të botës, Perëndia shpalli që puna e Tij ishte e mirë. Çdo gjë që e bëri nga atomet, molekulat, qelizat dhe pluhuri i tokës, Ai e quajti “të mirë”. Qiejtë e rinj dhe toka e re nuk mund të jenë vetëm shpirtërore (e kuptuar si jofizikë), sepse trupat tanë fizikë do të ringjallen. Një ringjallje jofizike është si një ylber pa ngjyra. Është kontradiktore! Kur apostulli Pal përshkruan ringjalljen tonë, thotë:

Në një çast, sa hap e mbyll sytë, në tingullin e borisë së fundit; sepse do të bjerë boria, të vdekurit do të ringjallen të paprishshëm dhe ne do të shndërrohemi, sepse kjo prishje duhet të veshë mosprishjen dhe e vdekshmja të veshë pavdekësinë. Edhe prishja, kur të veshë mosprishjen, edhe kjo e vdekshmja kur të veshë pavdekësinë, atëherë do

të realizohet fjala që është shkruar: «Vdekja u përpi nga fitorja». (1 Korintasve 15:52-54)

Pali nuk na thotë këtu që ne do të jemi shpirtra pa trupa. Në fakt, na thotë të kundërtën. Ne do të kemi trupa - trupa të vërtetë si ato që kemi tani, por ata do të jenë të pavdekshëm. Nuk do të prishen më nga sëmundjet, mosha, vdekja, dhe nuk do të vdesin kurrë. Ata do të jenë absolutisht të përkryer në çdo mënyrë, mahnitshëm të bukur, pafundësisht të fortë, krejtësisht të shëndetshëm dhe të papërshkueshëm nga plakja dhe nga vdekja.

Bota në të cilën jetojmë tani na ofron një shikim kalimthi të gëzimeve dhe kënaqësive që do të përjetojmë kur Perëndia të sjellë qiejt e rinj dhe tokën e re (Zbulesa 21). Në librin e tij, *Parajsa*, Rendi Alkorn shpjegon: “Gjatë gjithë jetës sonë kemi ëndërruar për Tokën e Re. Sa herë shikojmë bukuri tek uji, era, te një lule, një dre, te një burrë, një grua ose te një fëmijë, ne kapim një pamje të parajsës. Ashtu si Kopshti i Edenit, toka e re do të jetë një vend me kënaqësi ndijore, bukuri që të lënë me gojë hapur, marrëdhënie që të kënaqin e të plotësojnë, dhe gëzim personal.”⁶ Nuk do të jetojmë në një mjedis steril apo të endemi nëpër retë e pafundme, pa patur asgjë për të bërë. Do të jetojmë në një tokë, e cila do të jetë e gjitha e re - si kjo ku jemi, veçse që nuk do të ketë stuhi, tërmete, thatësira, përmbytje apo ndonjë katastrofë tjetër natyrore. Kafshët nuk do të na bëjnë keq, por do të na shohin me dashamirësi si të zotët dhe kujdestarët e tyre.

Ne mund të mos jemi në gjendje ta përfytyrojmë çdo gjë për ekzistencën tonë pas ringjalljes në tokën e re, por për një gjë mund të jemi plotësisht të sigurt: Perëndia na ka krijuar për gëzim. Ai e krijoi tokën për gëzimin dhe kënaqësinë tonë. Të gjitha kënaqësitë tani janë mpakur nga rebelimi i njeriut, por Ai ka për qëllim që asnjë prej tyre të mos humbë. Gjithçka që është krijuar do të kthehet në gjendjen fillestare. Ai na do shumë, prandaj dëshiron që ne të përjetojmë të gjitha kënaqësitë, të cilat i kishte për qëllim Ai që ne t'i përjetonim që në fillim kur na krijoi.

A MUND TA DIMË QË RINGJALLJA KA NDODHUR?

A është e vërtetë? A është e besueshme?

Ringjallja e Jezusit ose ka ndodhur, ose nuk ka ndodhur. Ky është një realitet objektiv, dhe si i tillë nuk mund të jetë i vërtetë për një person dhe i rremë për një tjetër.

Si e dimë këtë? Unë (Shoni) bëra njëherë këtë eksperiment me studentët e mi. Vendosa një kavanoz të mbushur me sfera qelqi dhe i pyeta studentët: “Sa sfera janë në kavanoz?” Ata u përgjigjën duke bërë hamendësime të ndryshme: 221, 168, e kështu me radhë. Pastaj, pasi u thashë numrin e saktë, që ishte 188, i pyeta: “Cili nga ju ishte më afër numrit të saktë?” Të gjithë ishin dakord që 168-a ishte afër, dhe e kuptuan e pranuan që numri i sferave ishte një fakt objektiv, që nuk mund të përcaktohej nga preferenca personale.

Pastaj i dhashë secilit student karamele të markës “Starbërst”^d dhe i pyeta: “Cila është shija e duhur?” Siç mund ta merrni me mend, që të gjithëve iu duk pa kuptim kjo pyetje, sepse secili person kishte një preferencë që ishte e duhura për atë vetë. “Kjo është e saktë,” - thashë si përfundim. - “Shija e duhur ka të bëjë me preferencën e personit. Ka të bëjë me një mendim subjektiv ose preferencë personale, jo me një fakt objektiv.”

Më pas pyeta: “A janë pretendimet fetare fakte objektive, si numri i sferave në kavanoz, apo janë vetëm çështje të mendimit personal, si preferenca e dikujt për karamelet?” Shumica e studentëve u përgjigjën se pretendimet fetare ishin si puna e preferencave për shijet e karameleve. Atëherë hapa diskutimin për pretendimet objektive të krishterimit. Vura në dukje se krishterimi mbështetet në një fakt historik objektiv - ringjalljen e Jezusit. Iu kujtova atyre që, ndërsa shumë njerëz mund ta kundërshtojnë ringjalljen historike të Jezusit, ky nuk është lloji i pretendimit që mund të jetë “i vërtetë për ty, por i pavërtetë për mua.” Në ditën e tretë, varri ose ishte bosh, ose nuk ishte bosh - rrugë të mesme s’ka. Përpara se dikush të kuptojë fuqinë transformuese të ringjalljes së Jezusit, ai ose ajo duhet ta kuptojë që kemi të bëjmë me një fakt objektiv dhe nuk është çështje preferencash personale.

Si mundet dikush të fillojë të gjejë një përgjigje të vërtetë për pyetjen: A u ringjall Jezusi nga të vdekurit, apo jo? Një historian ekspert do të vërtetonte vlefshmërinë e rrëfimeve të dëshmitarëve, do të konfirmonte vdekjen e Jezusit me anë të kryqëzimit, do të shqyrtonte procedurat e varrosjes dhe do të konfirmonte fjalët për varrin bosh dhe për Jezusin e parë të gjallë në ditën e tretë. Pastaj do të ishte me vend të merrej në konsideratë çdo shpjegim alternativ i ngjarjes. Duket interesante? Prisni, pasi në pjesën tjetër të këtij libërthi, do të bëjmë pikërisht këtë gjë.

A e minojnë besueshmërinë historitë e mrekullive?

Sidoqoftë, së pari duhet të shqyrtojmë mundësinë që mrekullitë ndodhin, përpara se të analizojmë haptas provat për ringjalljen. Nëse mrekullitë nuk janë të mundura në vetvete, atëherë ringjallja nuk do të mund të kishte ndodhur, dhe ne duhet të kërkojmë disa shpjegime të natyrshme të ngjarjeve

^d Starburst.

për ta konfirmuar atë. Por, nëse dalim në përfundimin që mrekullitë janë sadopak të mundura, atëherë mund të jemi të hapur për të ndjekur provat, duke qenë të paanshëm.

Ndërsa bëjmë këtë studim, do të ishte mirë të mbajmë parasysh dy gjëra të rëndësishme që përmenden nga studiuesi i Dhiatës së Re, dr. Kreg Blombergu:

Kur bëhet fjalë për besueshmërinë e historive të mrekullive, ka një ndjenjë të vetvetishme ku edhe besimtari më i devotshëm ndjen të njëjtin tension që ndjen skeptiku. Për më tepër, edhe personi që i shikon si të mundshme mrekullitë, nuk beson çdo rrëfim të çuditshëm për të mbinatyrshmen.¹

Me fjalë të tjera, kurdo që dëgjojmë për një ngjarje që duket ndryshe nga mënyra se si funksionojnë zakonisht ligjet e natyrës, ne bëhemi natyrshëm më vigjilentë. Nuk duam që të mashtrohem. Prandaj krahasojmë atë që kemi dëgjuar me mënyrën se si funksionon natyra. Dhe ne e dimë që natyra funksionon sipas modeleve të përcaktuara e të parashikuara.

E megjithatë, në të njëjtën kohë, nuk duhet t'i paragjykojmë provat, duke përjashtuar mundësitë e mrekullive vetëm sepse ato nuk kanë vend në kategoritë tona. Nuk është shkencore të përcaktosh rezultatet e një kërkimi përpara se të kesh analizuar faktet. Për ta ilustruar problemin, shqyrtoni më poshtë këtë histori të vërtetë. Afër fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë, bota përfundimisht u njoh për herë të parë me ornitoringun. Ornitoringu, i cili rritet në Australi, e ka të gjithë trupin të mbuluar me gëzof, është i madh sa një lepur dhe është këmbëlopatë. Por, duke qenë se bën vezë, riprodhohet si zvarranik! Kur lëkura e ornitoringut u soll për herë të parë në Europë, u prit me habi shumë të madhe. Ishte gjitar apo zvarranik? Ornitoringu dukej kaq i çuditshëm, saqë, pavarësisht provave fizike të lëkurës dhe dëshmimeve nga dëshmitarët, shumë londinezë vendosën ta konsideronin si të sajuar.

Njerëzit filluan ta besonin vetëm atëherë kur një ornitoring i mbarsur u qëllua dhe u soll në Londër, që ata ta shikonin me sytë e tyre. Por, derisa ndodhi kjo, disa nga mendimtarët më të mëdhenj nuk donin ta pranonin ekzistencën e ornitoringut, dhe të tjerë i vinin në dyshim pretendimet unike për fiziologjinë e tij. Problemi, sipas apologjetit Ros Kliford, ishte që “nuk

përkonte me pikëpamjet e disa njerëzve lidhur me si funksiononte bota, prandaj e kundërshtuan dhe dhanë verdiktin, *edhe pse pesha e provave tregonte tjetër gjë.*²

Reagimi i njerëzve ndaj çështjes së ornitoringut është i ngjashëm me mënyrën se si reagojnë shumë njerëz ndaj ringjalljes. Shumë njerëz nuk duan t'i marrin në konsideratë provat për ringjalljen, sepse një ngjarje e tillë nuk përkon me pikëpamjen e tyre për botën. Sigurisht që një reagim i tillë tregon se nuk jemi objektivë, duke lejuar që qëndrimet e njëanshme të sundojnë mbi arsyen, kur shqyrtojmë provat.

Në vend që të dalim në përfundimin se mrekullitë janë të pamundura, përpara se të bëjmë hetime të mjaftueshme - ose edhe që mrekullitë ndodhin me siguri - ne duhet të marrim një pozicion neutral që pranon se mrekullitë mund të ndodhin ose jo. Atëherë do të mund të analizojmë provat me objektivitet dhe do të shohim se ku na drejtojnë ato.

Kreg Blombergu na shpjegon pozicionin e atyre që mbrojnë vlefshmërinë e të dyjave, ligjeve të shkencës dhe ekzistencës së mrekullive:

Pavarësisht gjithë zhvillimeve të mrekullueshme të fizikës, asnjë nuk e ka provuar akoma që, nëse Perëndia, siç është konceptuar nga hebrenjtë dhe të krishterët, ekziston, atëherë pse Ai herë pas here nuk mund të ketë pezulluar ose tejkalluar rregullat e fiksuara të natyrës.... Shkenca fizike sot duket të jetë shumë më e hapur ndaj mundësisë së Perëndisë, sesa ka qenë gjatë brezave të mëparshëm.³

Dr. Norman Gejsleri e shpjegon në këtë mënyrë:

Besimi në mrekulli nuk shkatërron *integritetin* e metodologjisë shkencore, por vetëm *sovrانيتin* e saj. Në të vërtetë tregon që shkenca nuk ka pretendime sovrane për t'i shpjeguar të gjitha ngjarjet si të natyrshme, por vetëm ato që janë të rregullta, të përsëritura dhe/ose të parashikueshme.⁴

Mrekullitë janë të pamundura vetëm nëse supozohet që Perëndia nuk ekziston. Pa prova të vërtetueshme për ateizmin, njeriu duhet të jetë i hapur jo

vetëm ndaj mundësisë që Perëndia ka ndërhyrë drejtpërdrejt në botë, por edhe ndaj provave që Ai e ka bërë këtë gjë.

Vërtetimi i historisë

Varri bosh, pëlhura prej liri, lëvizja e gurit të madh dhe shfaqja e Jezusit janë ose thjesht ide në mendjet tona, ose ngjarje të historisë. Prandaj kërkimet historike janë të nevojshme për të përcaktuar se ç'ndodhi në të vërtetë atë Pashkë.

Provat për vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit duhet t'i trajtojmë me ndershmëri, me paanësi dhe me një mendje të hapur. Pavarësisht se ne kemi konceptet dhe përfundimet tona të krijuara më parë për këtë çështje, nuk duhet të lejojmë që kërkimi të cenohet prej tyre. Le t'i lëmë provat të flasin vetë. Historiani Ronald Sider shkruan: "Ne kemi të drejtë të kërkojmë prova të forta për një ngjarje të supozuar, të cilën nuk e kemi përjetuar, por nuk guxojmë të gjuajmë realitetin nga përvoja jonë e kufizuar. Dhe unë do të sugjeroja që ne të kishim prova të forta për ringjalljen e Jezusit të Nazaretit."⁵

Ajo që po vendosim këtu është besueshmëria dhe saktësia e Shkrimeve, jo frymëzimi i tyre. Lexuesi mund të arrijë në përfundimin që Shkrimet janë të frymëzuara, por ky përfundim nuk është i nevojshëm për të analizuar jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit si një ngjarje historike.

Ringjallja e Krishtit duhet të analizohet me të njëjtat kritere që përdoren për të analizuar çdo ngjarje tjetër në histori. Besimi i kishës së hershme u mbështet mbi përvojën e njerëzve që kanë vëzhguar ngjarje të verifikueshme në botën reale. Për shembull, Luka thotë:

Mbasi shumë veta ndërmorën për të renditur tregimin e ngjarjeve që ndodhën në mesin tonë, ashtu si na i përcollën ata që e panë me sytë e tyre që nga fillimi dhe u bënë shërbyes të fjalës, m'u duk e mirë edhe mua, pasi i hetova të gjitha gjërat me kujdes që nga fillimi, të t'i shkruaj sipas radhës, fort i nderuari Teofil, që ti të njohësh vërtetësinë e gjërave që të kanë mësuar (Luka 1:1-4).

Qëllimi i kujdesshëm i Lukës ishte të lidhte faktet historike aktuale.

Të dhënat e dëshmitarëve okularë

Një arsye për t'u besuar historive të Dhiatës së Re për Krishtin është fakti se ato janë shkruar nga dëshmitarë okularë ose në bazë të të dhënave të dëshmitarëve okularë. Historiani dr. Luis Gotshok, kur shkruan për kontrollin e saktësisë së një burimi, thotë: "Aftësia për të thënë të vërtetën mbështetet pjesërisht në afërsinë e dëshmitarit me ngjarjen. *Afërsia* këtu përdoret edhe në kuptimin gjeografik, edhe në atë kronologjik."⁶ Shkrimtarët e Dhiatës së Re nuk po përcillnin thashetheme, por ngjarje që ata personalisht i hetuan dhe, në shumë raste, i panë me sytë e tyre:

- 2 Pjetrit 1:16 thotë: "Sepse nuk jua bëmë të njohur fuqinë dhe ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht, duke ndjekur përralla të sajuara me mjeshtëri, por *u bëmë dëshmitarë okularë* të madhëstisë së tij."
- 1 Gjonit 1:1 na thotë: "Atë që ishte nga fillimi, atë që kemi dëgjuar, atë që kemi parë me sytë tanë, atë që kemi vështruar dhe që duart tona e kanë prekur lidhur me Fjalën e jetës."
- Luka thotë: "Të cilëve, pas vuajtjes së tij, iu paraqit i gjallë me shumë prova bindëse, duke u parë prej tyre për dyzet ditë dhe duke folur për gjërat e mbretërisë së Perëndisë" (Veprat 1:3).
- Veprat 2:32 tregojnë dëshminë e Pjetrit: "Këtë Jezus, Perëndia e ka ringjallur; për këtë *të gjithë jemi dëshmitarë!*"
- Gjoni thotë: "Dhe ai që ka parë, ka dëshmuar për këtë dhe dëshmia e tij është e vërtetë; dhe ai e di se thotë të vërtetën, që ju të besoni" (Gjoni 19:35).

Për të mbështetur më tej dëshminë e tyre, apostujt refuzuan të mohonin besimin e tyre në Krishtin e ringjallur, edhe pse u kërcënuan, u goditën, u burgosën, dhe disa edhe u vranë për besimin e tyre. Në kapitujt e parë të *Veprave të Apostujve*, na thuhet se apostujt e shpallën Jezusin e ringjallur në mes të përndjekjes. Apostujt, me vullnetin e tyre, vunë jetën në rrezik, për shkak të bindjes të tyre të thellë që Jezusi ishte ngritur nga varri. Për shembull, në Jerusalem, apostujt u kërcënuan dhe u burgosën nga udhëheqësit fetarë, për arsye se shpallnin publikisht ringjalljen. E megjithatë, Pjetri dhe Gjoni, duke iu përgjigjur atyre, thanë: "Gjykoni ju, nëse është e drejtë para Perëndisë t'ju

dëgjojmë më shumë ju sesa Perëndinë. Sepse ne nuk mund të mos flasim për ato që kemi parë dhe dëgjuar” (Veprat 4:19-20).

Nuk ka të dhëna që ndonjë nga apostujt të jetë tërhequr. Dhe ne e dimë me siguri që disa prej tyre u martirizuan.⁷ Vetëm kjo gjë nuk provon që ringjallja është e vërtetë, por ama tregon se apostujt e besonin me të vërtetë. Ata nuk ishin gënjeshtarë.⁸

A e minojnë mospërputhjet besueshmërinë historike?

Me shumë mundësi, kundërshtimi më i zakonshëm ndaj besueshmërisë së rrëfimeve për ringjalljen, që gjendet te ungjijtë, është pretendimi se rrëfimet kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe prandaj nuk janë të dhëna historike të besueshme. Për shembull, katër ungjijtë na tregojnë se Maria ishte e para që e pa Jezusin e ringjallur, ndërsa te 1 Korintasve 15:5 na thuhet që dëshmitari i parë ishte apostulli Pjetër. Marku thotë se gratë që shkuan te varri për të vajosur Jezusin “panë një djalosh të ulur në të djathtë, të veshur me të bardha” (16:5), Mateu thotë se një ëngjëll ishte aty me një veshje të “bardhë si bora” (28:3), dhe Luka thotë: “Dy burra të veshur me rroba të ndritshme iu qëndruan pranë atyre” (24:4). A nuk e kundërshtojnë njëra-tjetrën këto të dhëna dhe në këtë mënyrë shkatërrojnë besueshmërinë e tyre?

Jo. Deklaratat mund të ndryshojnë nga njëra-tjetra dhe mund të mos jenë kontradiktore. Mund të ketë shpjegime për ndryshimet, që nuk e minojnë të vërtetën e secilës prej tyre. Prandaj barra e provës i takon atij që pretendon se një deklaratë është plotësisht kontradiktore.

Në të katër ungjijtë ka vështirësi, por studiuesit nuk duhet të nxitohen duke supozuar që kemi të bëjmë me kontradikta të vërteta. Shumica e studiuesve tashmë janë dakord që zhanri i ungjijve është biografi antike greko-romake. Ky lloj zhanri iu lejon autorëve, kur tregojnë, të njëjtën lloj ndryshueshmërie që kanë edhe njerëzit në bisedat e tyre të përditshme. Luka, për shembull, përdor një teknikë të quajtur “konspekt”, sipas së cilës koha shkurtohet për ta thjeshtuar përcjelljen e historive të ndryshme. Ai shkurton

veçanërisht kohën e ringjalljes, shfaqjet e Krishtit të ringjallur dhe ngritjen e tij në qiell, në një mënyrë që të lë përshtypjen se të gjitha këto ngjarje ndodhën në një të diel Pashke. Por Ungjilli sipas Gjonit na tregon që këto ngjarje ndodhën në një periudhe më të gjatë. A është kjo kontradiktë? Jo. Ngjeshja e ngjarjeve nga ana e Lukës ishte më tepër një mjet stilistik i pranuar në zhanrin e biografive greko-romake. Nëse i konsiderojmë këto ndryshime si kontradikta, kjo tregon më tepër faktin se nuk i njohim zhanret letrare, sesa që po vëmë në dyshim besueshmërinë e ungjijve.

Studiuesi i Dhiatës së Re, i ndjeri Xhon Uenheim, në librin e tij *Enigma e Pashkës*, na jep një harmonizim të mundshëm të ngjarjeve lidhur me ringjalljen. Pasi i shqyrtoi me kujdes shkrimet e ungjillit, ai del në këtë përfundim:

Nuk kisha dyshime se shkrimtarët e ungjillit ishin njerëz të ndershëm dhe të mirinformuar, ... por nuk i qëndroja idesë që të dhënat ishin të sakta në çdo detaj. Në të vërtetë, kur nisa të studioj të dhënat për ringjalljen, më bëri shumë përshtypje natyra në dukje komplekse e mospërputhjeve...

Pasi lexova çdo gjë të mundshme dhe studiova me kujdes tekstet në greqisht, dalëngadalë pashë të lidheshin shumë pjesë të mozaikut. Tani më duket sikur këto të dhëna për ringjalljen paraqesin në një mënyrë mbresëlënëse karakteristikat e mirënjohura të raportimit të saktë e të pavarur. Në dukje ato tregojnë një mungesë të madhe harmonie, por, kur i analizon nga afër detajet, dalëngadalë fillojnë e marrin kuptim.⁹

Pavarësisht ndryshimeve, një analizë më e thellë e historive të ringjalljes zbulon një harmoni të fshehur. Filozofi Stiven Dejvis vëren:

Pavarësisht ndryshimeve në detaje, të katërt ungjilltarët pajtohen në një masë jashtëzakonisht të madhe në ato që ne mund t'i quajmë faktet bazë. Të gjithë janë në një mendje, kur shpallin që: *herët në mëngjes, ditën e parë të javës, disa gra, midis tyre edhe Maria Magdalena, shkuan te varri; e gjetën varrin bosh; takuan një engjëll ose disa engjëj; atyre ose iu tha, ose e zbuluan që Jezusi ishte i gjallë.*

Ka një përputhje të dukshme ndërmjet Ungjillit të Gjonit dhe të paktën njërit prej ungjijve sinoptikë për secilën nga këto pika: *gratë e njoftuan Pjetrin dhe/ose dishepujt e tjerë për atë që kishin zbuluar, Pjetri shkoi te varri dhe zbuloi që varri ishte bosh, Jezusi i ringjallur iu shfaq grave dhe u dha porosi për dishepujt.*¹⁰

A na japin prova të forta mospërputhjet e dukshme?

Avokatë, filozofë, historianë, gazetarë dhe të tjerë kanë zbuluar se mospërputhjet e dukshme, në vend që ta ulin besueshmërinë e ungjijve, në të vërtetë e mbështesin atë. N. T. Rajti vë re se cilësia që kanë këto histori të treguara në ungjill dhe fakti që nuk janë kopje e njëra-tjetrës, u shton atyre vlerë në të vërtetë. “Kjo” - thotë ai, - “është ajo se si duhet të duket dhe të tingëllojë dëshmia e dëshmitarëve okularë.”¹¹

Dr. Pol Majeri del në përfundimin: “Mospërputhjet e historisë së ringjalljes kanë prirjen ta mbështesin më shumë sesa ta minojnë vërtetësinë e tyre. Ato provojnë se kanë qenë disa tradita të pavarura, që kanë rrjedhur si pasojë e disa ngjarjeve, të cilat duhet të kenë ndodhur në të vërtetë, ndaj dhe kanë dalë këto tradita.”¹²

Tani do të shikojmë disa nga provat që duhet të shpjegohen, nëse duam të kuptojmë se çfarë ndodhi atë Pashkë të parë.

Provat për ringjalljen

A vdiq, u varros dhe u ringjall Jezusi?

Kryqëzimi dhe vdekja e Jezusit

Hebrenjtë ishin plotësisht të vetëdijshëm që Jezusi e kishte parashikuar ringjalljen e Tij. Me frikën se ndjekësit e Tij do të merrnin masa të jashtëzakonshme, që të bënin të dukej se Jezusi kishte vdekur dhe ishte ringjallur përsëri, edhe ata, po ashtu, morën masa paraprake të jashtëzakonshme për t'u siguruar që Ai ishte i vdekur dhe do të qëndronte i vdekur. Masa e parë ishte vdekja me anë të kryqëzimit. Vdekja do të ishte publike, mizore dhe e sigurt.

Mizoria e kryqëzimit

Kryqëzimi ishte një metodë ekzekutimi e zakonshme në kohën e Krishtit. Ciceroni e quajti atë “tortura më mizore dhe më e urryer” dhe “dënimi ekstrem dhe përfundimtar për një skllav.”¹ Romakët zakonisht nuk i kryqëzonin qytetarët e tyre dhe e përdornin atë vetëm për skllavërit dhe kryengritësit, për të dekurajuar kryengritjet. Kjo ishte e tmerrshme dhe poshtëruese. Përdorej kryesisht në raste politike.

“Dhimbja ishte krejt e padurueshme,” - zbulon mjeku dr. Aleksandër Methërell. - “Në fakt, nuk ka fjalë për ta përshkruar; duhej të shpiknin një fjalë të re: *torturuese* (në anglisht *excruciating*). Në kuptimin e parë *excruciating* do të thotë “që del nga kryqi”. Mendoni pak: atyre iu desh të krijonin një fjalë të re, sepse gjuha s’kishte asnjë fjalë që të mund ta përshkruante dhimbjen e fortë munduese të shkaktuar gjatë kryqëzimit.”²

Zakoni i fshikullimeve

Pasi merrej nga gjykata vendimi për kryqëzimin, rregulli ishte që i akuzuari të lidhej pas një trau. Kriminelit i zhvisheshin rrobat dhe pastaj fshikullohej dhunshëm nga ushtarët. Ungjijtë tregojnë se Jezusi u fshikullua fort para kryqëzimit (Gjoni 19:1; Mateu 27:26; Marku 15:15).

Kamxhiku që përdorej zakonisht kishte një shkop të fortë, ku ishin lidhur rripa lëkure me gjatësi të ndryshme. Nëpër rripat e kamxhikut ishin shkuar copa të dhëmbëzuara kockash dhe plumbi. Një artikull në *Revistën e shoqatës mjekësore amerikane*, shkruan:

Ndërsa ushtarët romakë vazhdonin të godisnin me sa fuqi që kishin kurrizin e viktimës, sferat prej hekuri shkaktonin plagë të thella dhe rripat prej lëkure e kockat e deleve çanin lëkurën dhe indet nën lëkurë. Më pas, ndërsa vazhonte fshikullimi, plagët shkonin deri te muskujt e kockave dhe mishi kullonte gjak.³

Pa kujdes mjekësor, këto të çara të lëkurës dhe muskujve mund të shkaktonin vdekjen e personit brenda disa orëve ose brenda disa ditëve.

Si e shkakton vdekjen kryqëzimi

Kur varej në kryq, viktimja e kishte shumë të vështirë të merrte frymë. Që të merrte dhe të nxirrte frymë siç duhej, ai duhej ta ngrinte veten lart me anë të duarve dhe këmbëve, gjë që i shkaktonte dhimbje shumë të forta. Me kalimin e kohës, viktimja rraskapitej kaq shumë nga përpjekjet dhe humbja e gjakut, sa që nuk mundej më t'i bënte lëvizjet për të marrë frymë, dhe mbytej.

Nëse romakët donin ta shpejtonin vdekjen e viktimës, metoda kryesore që i jepte fund kryqëzimit ishte thyerja e kockave të këmbëve me një kopaçe, që ta pengonte viktimën të shtynte trupin lart për të marrë frymë. Pas thyerjes së këmbëve të viktimës, vdekja ishte shumë e shpejtë. Këmbët e dy hajdutëve, që u kryqëzuan me Krishtin, u thyen, kurse të Krishtit jo, pasi ekzekutuesit panë që Ai kishte vdekur.

Rrjedhja e gjakut dhe ujit

Pasi u pa se Jezusi kishte vdekur, një nga xhelatët romakë i tejshpoi brinjën me një heshtë dhe “menjëherë i doli gjak e ujë” (Gjoni 19:34). Autori anglez Majkëll Grin e shpjegon kështu domethënien e kësaj:

Ne na është thënë me autoritetin e dëshmitarit okular që nga tejshpimi në brinjë i Jezusit doli “gjak dhe ujë” (Gjoni 19:34-35). Është e qartë që dëshmitari okular i jep kësaj gjëje një rëndësi të madhe. Nëse Jezusi do të kishte qenë gjallë kur iu ngul heshta në brinjë, gjaku do t'i kishte rrjedhur çurg në çdo rrahje zemre. Por, në vend të kësaj, dëshmitari vuri re që i doli një copë gjaku gjysmë e mpiksuar, me ngjyrë të kuqe të errët, e dallueshme dhe e ndarë nga masa e lëngshme prej uji që doli bashkë me të. Kjo është provë për një mpiksje të madhe të gjakut në arteriet kryesore, dhe është veçanërisht provë e fortë mjekësore për vdekjen. Të bën akoma më shumë përshtypje sepse ungjilltari me shumë mundësi as që e ka kuptuar domethënien që ka ajo për një patolog. “Gjaku dhe uji” nga shpimi me heshtë është një provë që konfirmon se Jezusi tashmë kishte vdekur.⁴

Pilati kërkoi të sigurohej për vdekjen e Krishtit, përpara se trupi t'i jepej Jozefit nga Arimatea. Ai dha pëlqimin që të hiqej trupi nga kryqi, vetëm pasi

RINGJALLJA DHE TI

centurioni, që kishte përgjegjësinë për ekzekutimin e Jezusit, kishte vërtetuar vdekjen e Tij.

Jezusi ishte përfundimisht i vdekur. Pjesa dërrmuese e historianëve as që e vënë në dyshim këtë fakt. Dr. Geri Habermasi vë në dukje se ekzistojnë prova të rëndësishme për vdekjen e Jezusit nga burime jo të krishtera. Në këto burime hyjnë Kornel Taciti (55-120 pas Krishtit), i cili konsiderohet nga shumë njerëz si historiani më i madh romak i antikitetit; studiuesi hebre Flav Jozefi (37-97 pas Krishtit); dhe Talmudi i judenjve (70-200 pas Krishtit). Për këto shkrime nga jo të krishterë, Habermasi thotë: “Vdekja e Jezusit është ajo që është përcjellë më shpesh, e përmendur nga dymbëdhjetë burime. Këto burime laike, të datuara përafërsisht 20 deri 150 vjet pas vdekjes së Jezusit, konsiderohen mjaft të hershme, sipas standardeve të historiografisë antike.”⁵

Fakti që Jezusi në të vërtetë u vra është po aq i sigurt sa çdo ngjarje tjetër e regjistruar në historinë antike. Ne duhet ta kundërshtojmë çdo teori që përpiqet të shpjegojë ringjalljen, duke thënë se Jezusi, në një farë mënyre, i mbijetoi provës së Tij të rëndë, iu shfaq dishepujve të Tij i mbuluar në gjak, dhe i bindi ata t’u thoshin njerëzve se Ai ishte ringjallur.

Varrimi i Krishtit

Shumë skeptikë janë përqendruar te ngjarjet dhe mjedisi përreth, në kohën e varrimit të Krishtit, për të gjetur boshllëqe në deklaratat e bëra lidhur me ringjalljen e Tij nga të vdekurit. Prandaj është e rëndësishme që të shikojmë me kujdes faktet historike dhe të kontrollojmë besueshmërinë dhe saktësinë e tyre. Siç e përmendëm më sipër, zyrtarët morën disa masa sigurie paraprake, për të parandaluar daljen e ndonjë historie sikur Jezusi ishte kthyer nga të vdekurit. Së pari, do të analizojmë faktet për vetë varrin.

Një varr në shkëmb të fortë

Të katër ungjijtë tregojnë se trupi i Jezusit u vendos në një varr të hapur brenda në shkëmb dhe një gur i madh mbylli hyrjen e tij. Mateu, Luka dhe

Gjoni theksojnë se ishte një varr i ri, ku ende nuk ishte vënë asnjëri (Mateu 27:60; Luka 23:53; Gjoni 19:41). Mateu tregon se varri ishte në pronësi të Jozefit të Arimateas.

Arkeologët kanë zbuluar tri lloje varresh të hapura në shkëmb, që përdoren gjatë kohës së Jezusit. Të gjitha mbylleshin duke mbuluar hyrjen me një gur në formë disku, që peshonte mesatarisht dy ton. Çdo varr kishte një kanal ose një lug të gdhendur në shkëmb, në pjesën ballore të tij, që shërbente si ulluk për lëvizjen e gurit. Pjesa më e thellë e lugut ishte në pjesën qendrore të hyrjes dhe vinte duke u ngritur në pjesët anësore. Guri në formë disku vendosej në pjesën më të lartë të lugut dhe poshtë tij vendosej një pengesë që nuk e lejonte të rrotullohej. Kur hiqej pengesa, guri mund të rrotullohej me lehtësi dhe të ndalonte përpara hyrjes.

Është e qartë që, nëse trupi i Krishtit ishte vulosur në një varr të tillë, do duheshin përpjekje të jashtëzakonshme për ta nxjerrë trupin përjashta.

Ne kemi arsye thelbësore për të qenë të sigurt se Jezusi u varros siç na paraqitet tek ungjijtë. Së pari, Pali konfirmon historinë e varrimit te 1 Korintasve 15:3-5. Ka prova bindëse që Pali i mori para se të shkruante, të cilat datojnë tre deri në tetë vjet nga vdekja e Krishtit. Kështu, historia e varrimit mund të shihet nga kaq afër kohës kur vdiq Jezusi, sa që trillimi i legjendave do të ishte realisht i pamundur.

Së dyti, tradita e varrimit nuk shoqërohet me zbukurime apo stolisje. Ajo tregohet në një mënyrë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë.

Së treti, nuk ekziston asnjë traditë që e kundërshton historinë e varrimit. Nuk ka dokumente të hershme që të hedhin poshtë historinë e varrimit të paraqitur tek ungjijtë.

Së katërti, është shumë e pazakontë që të krishterët të shpiknin një figurë historike të tillë si Jozefi i Arimateas, anëtar i gjykatës që e dënoi Jezusin. Pse do të donin të krishterët e hershëm të bënin hero pikërisht një anëtar të gjykatës përgjegjëse për vdekjen e Jezusit? Nëse apostujt po e sajnin historinë e varrosjes, me shumë mundësi nuk do të kishin sajuar një figurë si ajo e Jozefit. Përfshirja e Jozefit, në të katër ungjijtë, si ai që varrosi Jezusin, i vendos kësaj ngjarjeje unazën e vërtetësisë.

Studiuesi i Dhiatës së Re Rajmond Braun del në këtë përfundim: “Që Jezusi u varros, është e sigurt nga ana historike.... Që varrosja u bë nga Jozefi i Arimatesë, është shumë e mundur.”⁶

Procedurat hebraike të varrimit

Dhiata e Re na e bën shumë të qartë që varrosja e Krishtit u bë sipas zakoneve hebraike. Jezusi u zbrit nga kryqi dhe u mbulua me një çarçaf. Hebrenjtë ishin të prerë për të mos e lejuar trupin të qëndronte gjithë natën në kryq.

Në Dhiatën e Re, na thuhet që dy burra, Nikodemi dhe Jozefi i Arimatesë, e përgatitën trupin e Krishtit për ta varrosur (Gjoni 19:38-42). Zakoni hebre ishte që trupi të vendosej në një platformë guri në dhomën e varrimit. Trupi, së pari, lahej me ujë të ngrohtë.

Në atë kohë, siç vërtetohet edhe në Dhiatën e Re, ishte traditë që të përgatitej trupi me lloje të ndryshme të bimëve aromatike. Në llogaritim që, për varrimin e Jezusit, u përdorën tridhjetë e një deri në dyzetë e pesë kilogram bimë aromatike. Kjo ishte një sasi e arsyeshme për një udhëheqës. Për shembull, për përgatitjen e trupit të Gamalielit, nipit të studiuesit të njohur hebre Hillel dhe bashkëkohës i Jezusit, u përdorën tridhjetë e nëntë kilogram. Jozefi shkruan se, kur vdiq mbreti Herod, u deshën pesëqind shërbëtorë për të mbajtur erëzat.⁷

Përdorimi i pëlhurës prej liri

Pasi drejtoheshin të gjitha pjesët e trupit, trupi mbështillej me pëlhurën e varrimit prej liri të bardhë. Pëlhurat prej liri për të vdekurin qepeshin nga gratë. Nuk lejohej të bëhej asnjë njëj. Asnjë njeri nuk mund të varrosej me më pak se tri pëlhura të veçanta.

Tani, aromat, që përbëheshin nga copëza të një druri aromatik të bluar i njohur si aloe, bashkoheshin me një substancë ngjitëse që quhej mirrë. Trupi

RINGJALLJA DHE TI

mbështillej me pëlhurën prej liri, duke filluar nga këmbët, dhe erëzat e përziera me mirrën ngjitëse vendoseshin ndërmjet mbështjelljeve. Ata që e përgatitnin, e mbështillnin trupin deri te sqetullat, i ulnin krahët poshtë, jashtë mbështjelljes, dhe pastaj e mbështillnin deri te qafa. Një pëlhurë tjetër i mbështillej rreth kokës. Në fund, mbështjellja peshonte rreth 53 - 54 kilogramë.

Gjon Gojarti (Joan Gojarti), në shekullin e katërt pas Krishtit, tha se mirra e përdorur ishte një substancë që ngjitej kaq fort me trupin, sa që pëlhurat e të vdekurit nuk mund të hiqeshin me lehtësi.”⁸

Masat paraprake të sigurisë

Rojet romake të sigurisë

Zyrtarët hebrenj i kishte zënë frika, sepse qindra njerëz kishin ardhur te Jezusi. Për të shmangur një problem politik, ishte në dobi edhe të romakëve, edhe të hebrenjve të siguroheshin që Jezusi të zhdukej njëherë e mirë. Prandaj, pas kryqëzimit, kryepriiftërinjtë dhe farisenjtë i thanë Pilatit:

“Zot, na ra në mend se ai mashtruesi, sa ishte gjallë, tha: ‘Pas tri ditësh do të ringjallem.’ Prandaj urdhëro që varri të ruhet mirë deri në ditën e tretë, se mos vijnë dishepujt e tij natën ta vjedhin trupin dhe t’i thonë popullit: ‘U ringjall prej së vdekurish’; kështu mashtrimi i fundit do të ishte më i keq se i pari.”

Por Pilati u tha atyre: ‘Rojën e keni; shkoni dhe siguronit varrin, si të dini. Dhe ata, pra, shkuan dhe mbasi e vulosën gurin e siguruan varrin me rojë.’” (Mateu 27:63-66)

Legjionet e famshme romake ishin mjeti me anë të të cilit Cezari rimori kontrollin e perandorisë së tij të madhe. Perandoria Romake u detyrohej për ekzistencën dhe vazhdimësinë e saj këtyre luftëtarëve të stërvitur sipas standardeve më të larta, të cilët qenë ndër makineritë më të fuqishme të luftimit që janë përgatitur ndonjëherë.⁹

RINGJALLJA DHE TI

Shumë burime të shkëlqyera që dëshmojnë për disiplinën e ushtrisë romake, na tregojnë që një njësi rojeje ishte një forcë sigurie që përbëhej nga katër deri gjashtëmbëdhjetë ushtarë. Çdo ushtar ishte stërvitur të mbronte një territor prej rreth 1,83 m. Gjashtëmbëdhjetë ushtarë, të vendosur nga katër në secilën anë të një katrori, supozohej të mbronin 33 metra dhe të luftonin kundër një batalioni të tërë.

Zakonisht, një njësi me detyrën për të mbrojtur një zonë, funksiononte në këtë mënyrë: katër ushtarë vendoseshin direkt përpara objektit që do të mbronin. Dymbëdhjetë të tjerët flinin në një gjysmë rrethi përpara tyre, me kokat e drejtuara nga brenda. Për të vjedhur atë që këta ushtarë po mbronin, hajdutëve, së pari, do t'u duhej të kalonin rojet që ishin në gjumë. Çdo katër orë zgjohej një njësi tjetër prej katër rojesh, dhe ata që kishin qenë zgjuar merrnin turnin për të fjetur. Ata organizoheshin kështu me turne për gjatë gjithë kohës.

Vula romake

Mateu thotë se ata shkuan dhe, mbasi e vulosën gurin, e siguruan varrin me roje (Mateu 27:66). Studiuesi i Biblës A.T. Robertson thotë se guri mund të vulosej vetëm në praninë e ushtarëve romakë, të cilët ishin lënë me detyrën për të ruajtur.¹⁰ Qëllimi i kësaj procedure ishte që të ndalonte ndonjë njeri që mund të futej të trazonte gjërat që ndodheshin brenda varrit.

Rojet, pasi inspektuan varrin, rrotulluan gurin dhe e vendosën në vend. Përmes gurit u vendos një litar, i cili u fiksua në të dyja anët me argjilë. Në fund, mbi argjilën u vendos vula zyrtare e guvernatorit romak.

Vula romake garantonte që trupi i Krishtit të mbrohej prej vandalëve nga vetë fuqia dhe autoriteti i Perandorisë Romake. Çdo njeri që do të përpiqej të lëvizte gurin, do të prishte vulën, dhe në këtë mënyrë mbi të do të binte zemërimi i ligjit dhe pushtetit romak.

Fakte për ringjalljen, që duhen mbajtur parasysh

RINGJALLJA DHE TI

Pavarësisht nga ajo që beson secili për Krishtin dhe ringjalljen, të gjithë duhet ta pranojnë që diçka e rëndësishme ndodhi atë mëngjes - diçka kaq e papritur, saqë i ndryshoi plotësisht jetët e njëmbëdhjetë burrave dhe i bëri ata të duronin fyerjet, vuajtjen dhe, në shumë raste, edhe vdekjen. Kjo diçkaja ishte një varr i zbrazët - një varr i zbrazët që, me një ecje pesëmbëdhjetëminutëshe nga qendra e Jerusalemit, do të ishte konfirmuar ose hedhur poshtë shumë lehtë!

Njoftimet për varrin e zbrazët dhe shfaqjet e Jezu Krishtit të ringjallur kanë shkundur themelet e mendimit dhe kanë ndikuar rrjedhën e historisë që nga ajo kohë e në vazhdim. Është e qartë që diçka ndodhi. Diçka e madhe!

Nëse dëshiron të heqësh dorë nga racionalizimi i ngjarjeve rreth vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit dhe t'i shpjegosh ato në mënyrë të mbinatyrshme, duhet të merresh me disa të panjohura. Hebrenjtë dhe romakët ndërmorën hapa të kujdesshëm, për t'u siguruar që Jezusi ishte i vdekur dhe do të mbetej në varr. Fakti që diçka ndodhi, pavarësisht masave që kishin marrë ata - kryqëzimin, varrimin, vulosjen dhe ruajtjen e varrit - e bën shumë të vështirë për kritikët të mbrojnë pozicionin e tyre që Krishti nuk është ringjallur nga të vdekurit.

Le t'i shikojmë disa nga këto ngjarje përsëri dhe të marrim parasysh disa përfundime.

Fakti numër 1: Vula romake është prishur

Mëngjesin e Pashkës, vula që përfaqësonte pushtetin dhe autoritetin e Perandorisë Romake ishte prishur. Askush nuk e mohon këtë fakt. Pasojat për prishjen e vulës ishin të rënda. Kur personi apo njerëzit përgjegjës do të arrestoheshin, do të merrnin ndëshkime të rënda. A do të kishin guxuar dishepujt e Krishtit ta prishin atë vulë? Si zor! Pas arrestimit të Tij, ata treguan shenja pështjellimi dhe frike. Madje, Pjetri edhe e mohoi që e njihnte Krishtin.

Fakti numër 2: Varri është bosh

Një fakt tjetër i dukshëm, atë mëngjes të diele, ishte që varri ishte bosh. Askush nuk e mohoi asnjëherë që varri ishte bosh. Është i rëndësishëm fakti që, pas ringjalljes, dishepujt që kishin marrë guxim papritur nuk u nisën për në Athinë apo Romë për të predikuar se Ai ishte ringjallur; ata shkuan drejt e në qytetin e Jerusalemit, ku, nëse ajo që ata po shpallnin ishte e rremë, mesazhi i tyre do të përgënjeshtrohej shumë lehtë. Dëshmia për ringjalljen nuk do të kishte qëndruar për asnjë moment në Jerusalem, nëse varri nuk do të kishte qenë bosh. Pol Majeri shpjegon:

Ajo që ndodhi në Jerusalem, shtatë javë pas Pashkës së parë, do të kishte ndodhur vetëm nëse trupi i Jezusit mungonte në një farë mënyre në varrin e Jozefit, përndryshe udhëheqësit e Tempullit, në këtë situatë të ndërlikuar me apostujt, do ta kishin shkatërruar lëvizjen, duke bërë një vizitë të shpejtë te varri në shkëmb i Jozefit të Arimatesë dhe do të zbulonin Provën A^c. Ata nuk e bënë këtë gjë, sepse e dinin se varri ishte bosh. Shpjegimi zyrtar i tyre për këtë - që dishepujt kishin grabitur trupin - ishte një pohim që varri në shkëmb ishte në të vërtetë bosh.¹¹

Disa e kanë kundërshtuar historinë e varrit bosh, me pretendimin se ishte më tepër një legjendë që u krijua ose një mjet apologjetik, dhe jo fakt historik. Por një nga provat më bindëse që tregon se historia e varrit bosh nuk ishte as një mjet apologjetik, dhe as një legjendë, është fakti që, të parat që e zbuluan varrin bosh, ishin gratë. Në Palestinën e shekullit të parë, gratë kishin një status të ulët si shtetase apo si dëshmitare të ligjshme. Përveçse në disa rrethana të rralla, ligji hebre nuk i lejonte gratë të dëshmonin në një gjykatë të ligjit. Përse, ata që dëshironin të çonin përpara krishterimin, do të krijonin një legjendë, që do t'i turpëronte dishepujt - mbështetësit kyçë të besimit të ri - duke bërë që ata të fshihen gjatë kryqëzimit dhe, në vend të tyre, të ishin gratë që i afrohen varrit me kurajo dhe japin dëshminë e parë për faktin që varri ishte bosh? Një legjendë e tillë nuk do t'i kishte shërbyer qëllimit për të çuar përpara kauzën. Logjika na thotë se arsyeja më e mirë pse thuhet se gratë janë dëshmitaret e para, është sepse kjo është e vërteta.

^c *angl. Exhibit A*, është një term që ka të bëjë me mënyrën tradicionale të klasifikimit të elementit të parë të faktit material në një proces gjyqësor për një krim të ndodhur, apo të faktit kryesor.

Fakti numër 3: Rojet romake MUNGOJNË

Ushtarët romakë u larguan nga vendi i tyre i detyrës. Ky është një fakt shumë i çuditshëm, që duhet shpjeguar.

Dr. Xhorxh Këri, i cili studioi me kujdes disiplinën ushtarake të romakëve, tregon se kishte dënim me vdekje për disa lloje rastesh kur nuk kryhej detyra, si dezertimi, humbja ose hedhja e armës, tradhtia dhe nxjerrja e informacionit të armiku, mospranimi për të mbrojtur një oficer dhe mosrealizimi i detyrës së rojes së natës.¹² Këtyre mund t'u shtohet dhe rasti kur i zinte gjumi në detyrë (Mateu 28:13). Nëse nuk ishte e qartë se cili ushtar nuk e kishte bërë detyrën e tij, atëherë hidhej short për të vendosur se cili do të ndëshkohej me vdekje, pasi kishte bërë që rojet të mos kryenin detyrën.

Një mënyrë se si dënohej me vdekje një ushtar ishte: i hiqeshin rrobat dhe digjej i gjallë në një zjarr të ndezur me rrobat e tij. Historia e disiplinës dhe sigurisë romake dëshmon për faktin që, nëse varri nuk do të kishte qenë bosh, ushtarët nuk do të ishin larguar kurrë nga vendet e tyre. Frika nga zemërimi i eprorëve dhe nga dënimi me vdekje tregon që ata i kushtonin vëmendje të veçantë edhe detajit më të vogël të punës së tyre.

Dr. Bill Uajti, i cili ka qenë përgjegjës për Varrin në Kopsht në Jerusalemin, ka studiuar gjerësisht ringjalljen dhe ngjarjet që pasuan Pashkën e parë. Uajti bën disa vëzhgime të rëndësishme për autoritetet hebraike, që u dhanë ryshfet rojeve romake (Mateu 28:11-14):

Nëse guri thjesht ishte rrokullisur në njërën anë të varrit, sepse do të ishte e nevojshme që të hyje në të, atëherë ata mund të ishin të justifikuar të akuzonin ushtarët që i kishte zënë gjumi në detyrë dhe t'i dënonin ashpër. Nëse rojet pohuan se vulën e prishi tërmeti dhe se guri shkoi në vend nga dridhjet, ata përsëri do të konsideroheshin fajtorë dhe do të ndëshkoheshin për sjellje që do të cilësohej si frikë. Por këto nuk ishin të mjaftueshme. Ekzistonin disa prova të pamohueshme, të cilat e bënë të pamundur që kryepriiftërinjtë të ngrinin akuza ndaj rojeve. Autoritetet hebraike duhet ta kenë inspektuar vendngjarjen, ta kenë kontrolluar gurin, dhe ta kanë pranuar pozicionin e tyre që,

nga ana njerëzore, ka qenë e pamundur që njerëzit e tyre të mund të kishin lejuar heqjen e gurit. Asnjë dredhi e gjenialitetit njerëzor nuk mund të jepte një përgjigje të mjaftueshme apo të bënte me faj dikë, dhe kështu ata ishin të detyruar t'u jepnin ryshfet rojeve dhe të kërkonin t'i linin gjërat në heshtje.¹³

Fakti numër 4: Pëlhurat e varrimit tregojnë një histori

Atë të diel në mëngjes, ndonëse mungonte trupi në varrin e Krishtit, varri nuk ishte plotësisht bosh. Aty brenda kishte ndodhur një dukuri e jashtëzakonshme. Pasi shkuan te varri dhe panë gurin që kishte lëvizur, gratë vrapuan dhe u treguan dishepujve. Pastaj Pjetri dhe Gjoni vrapuan. Gjoni e kaloi Pjetrin dhe, kur mbërriti te varri, nuk hyri, por u zgjat, hodhi një sy brenda dhe pa diçka kaq tronditëse, sa që menjëherë besoi se Krishti ishte ringjallur vërtet nga të vdekurit.

Ai i hodhi një sy vendit ku kishte qenë shtrirë trupi i Jezusit. Pa vetëm pëlhurat e varrimit që ishin bosh (*të pazgjidhura*). Vetëm kaq! Pas kësaj, ai nuk do të ishte më kurrë i njëjti.

Gjëja e parë që iu mbeti në mendje dishepujve, nuk ishte aq shumë varri bosh, por pëlhurat e të vdekurit bosh. Majkëll Grini ka thënë me të drejtë: “S’është çudi që ata ishin të bindur dhe të mahnitur. Asnjë vjedhës varrezash nuk do të kishte mundur të kryente një gjë kaq të jashtëzakonshme. As që do t’i kishte shkuar ndërmend. Ai do kishte marrë trupin, pëlhurat dhe çdo gjë.”¹⁴

Fakti numër 5: Shfaqjet e Krishtit janë konfirmuar

Pak studiues, në ditët e sotme, e dyshojnë se dishepujt të paktën *besonin* që ata e kishin parë Jezusin e ringjallur. Studiuesi i Biblës Rexhinald Fullër ka theksuar që “brenda disa javëve pas kryqëzimit, dishepujt e Jezusit arritën të besonin që ky është një nga faktet e pakundërshtueshme të historisë”.¹⁵ Çfarë i bëri dishepujt të kishin këtë mendim? Që nga fillimi i kishës ishte shpallur se Jezusi iu shfaq personalisht ndjekësve të Tij.

Kur studion një ngjarje të historisë, është e rëndësishme të hetosh nëse ka mjaft njerëz nga ata që kishin qenë pjesëmarrës ose dëshmitarë okularë të

ngjarjes, të cilët ishin akoma gjallë në kohën kur dolën faktet rreth ngjarjes. Një numër më i madh dëshmitarësh ndihmojnë për të vërtetuar saktësinë e fakteve të paraqitura.

Një nga faktet më të hershme të shfaqjes së Krishtit pas ringjalljes është nga Pali te 1 Korintasve 15:3-8.

Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash atë që edhe mora, se Krishti vdiq për mëkatet tona, sipas Shkrimeve, dhe se u varros dhe se u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve, dhe se iu shfaq Kefës, pastaj të Dymbëdhjetëve. Më pas iu shfaq një herë të vetme më shumë se pesëqind vëllezërve, prej të cilëve më të shumtët rrojnë deri më sot, kurse disa kanë fjetur. Më pas iu shfaq Jakobit dhe pastaj të gjithë apostujve. Dhe në fund të të gjithëve m'u shfaq edhe mua, si një dështaku.

Pothuajse të gjithë studiuesit bien dakord që Pali, me këto vargje, fakton një besore të lashtë ose traditë, e cila daton përpara shkrimit të 1 Korintasve (në mes të viteve 50 pas Krishtit). Në fakt, shumë studiues që e kanë shqyrtuar këtë besore, mendojnë se ajo i përket periudhës 3-8 vjet pas kryqëzimit të Krishtit. Besohet që Pali e mori këtë besore kur takoi Pjetrin dhe Jakobin në Jerusalem, tre vjet pas konvertimit të tij, që ka ndodhur 1-4 vite pas kryqëzimit të Jezusit (Galatasve. 1:18-19). Ja pse historiani Hans fon Kampenhauzen thotë se ky tekst “i plotëson të gjitha kërkesat e mundshme për besueshmërinë historike.”¹⁶

Në këto vargje, Pali u kujton dëgjuesve të tij faktin që Krishti ishte parë nga më shumë se pesëqind njerëz në të njëjtën kohë. Ai u kujton atyre që shumica e këtyre njerëzve ishin akoma gjallë dhe mund të pyeteshin. Kjo deklaratë është prova më e fortë që kushdo mund të shpresonte të gjente për diçka që ka ndodhur dy mijë vjet më parë.

Po ashtu, studiuesi i Dhiatës së Re Çarls Harold Dod ka theksuar: “S’ka qëllim tjetër përmendja e faktit që pjesa më e madhe e pesëqind vetave janë akoma gjallë, përveçse Pali po thotë që praktikisht “dëshmitarët janë aty për t’u pyetur.”¹⁷

Ndër dëshmitarët hyjnë dhe disa kundërshtarë ose jo të bindur për ringjalljen e Tij. Asnjë individ i informuar nuk do ta kishte konsideruar Saulin e Tarsit si një ndjekës të Krishtit. Ai e përçmonte Krishtin dhe i përndiqte të

krishterët, me qëllim që ta çrrënjoste të gjithë lëvizjen e krishterë. E megjithatë, Sauli, emri i të cilit më vonë u ndryshua në Pal, u bë një nga propaganduesit më të mëdhenj të lëvizjes së krishterë në histori. Çfarë mund ta kishte shkaktuar këtë transformim rrënjësor? Nuk do të kishte mjaftuar asgjë më pak sesa një shfaqje personale nga Jezusi i ringjallur (1 Korintasve 9:1; Veprat 22:4-21).

Mendoni Jakobin, vëllanë e Jezusit. Shkrimet e ungjillit tregojnë që asnjë nga vëllezërit e Jezusit nuk besoi te Ai gjatë jetës së Tij (Gjoni 7:5; Marku 3:21-35). Në fakt, ata u përpoqën ta mashtronin Jezusin dhe ta fusnin në një kurth vdekjeje, në një festë publike në Jerusalem. E megjithatë, më vonë, Jakobi u bë ndjekës i vëllait të Tij dhe iu bashkua grupit të të krishterëve të përndjekur, duke u bërë një nga udhëheqësit kyçë në kishë dhe një nga martirët e hershëm të saj, siç është vërtetuar nga Jozefi, Hegesipi dhe Klementi i Aleksandrisë. Çfarë e solli një ndryshim të tillë në qëndrimin e tij? A s'ishte fakti që edhe Jakobi e pa Jezusin pas ringjalljes?

Përpjekjet për të “gjetur shpjegim për” ringjalljen

Shumë teori kanë shkuar deri aty sa janë përpjekur të tregojnë që ringjallja e Jezu Krishtit ishte mashtrim. Shumica e fakteve për ringjalljen janë të pamohueshme, prandaj këto përpjekje janë mbështetur në një interpretim të ndryshëm të këtyre fakteve, duke kërkuar një shpjegim legjendar, mitik ose të natyrshëm. Pak skeptikë i mohojnë ngjarjet thelbësore - gjyqin, kryqëzimin, varrimin, rojet, vulosjen e varrit ose varrin bosh - sepse provat historike që i mbështesin këto ngjarje janë mjaft të forta. Ata e mohojnë se këto ngjarje tregojnë që një njeri i vdekur erdhi përsëri në jetë. Qëndrimi i tyre mund të përmblihet kështu: “Po, por duhet të ketë ndonjë shpjegim tjetër.”

Për të besuar disa nga këto teori, duhet më shumë besim sesa për të pranuar shpjegimet që na janë dhënë në Dhiatën e Re. Ne e kemi trajtuar secilën teori me detaje në librin tonë *Prova për ringjalljen*. Këtu do të themi që një teori duhet t'i shpjegojë të gjitha faktet, përfshirë faktin që apostujt ishin të gjithë gati të vuanin dhe të vdisnin për shkak se besonin që Jezusi u ringjall fizikisht të tretën ditë. Nëse ringjallja ishte mashtrim, atëherë pse ata me vullnetin e tyre ishin gati të vuanin dhe të vdisnin për të? Disa kanë thënë se ata kishin një halucinacion masiv, por psikologët na thonë që halucinacionet janë përvoja individuale, dhe është e pamundur që një grup njerëzish të kenë të njëjtin halucinacion. Shpjegimet alternative nuk përputhen me faktet.

ÇFARË VJEN MË PAS?

Si i vlerësoni provat historike për ringjalljen e Jezu Krishtit të paraqitura në këtë libër? Cili është vendimi juaj lidhur me faktet e dokumentuara për varrin e Krishtit që ishte bosh? Çfarë mendoni *ju* për Krishtin?

Kur unë (Xhoshi) gjeta kaq shumë prova për ringjalljen e Krishtit, m'u desh të bëja pyetjen logjike: “Çfarë ndryshimi sjell në jetën time, nëse e besoj ose jo që Krishti vdiq në kryq për mëkatet e mia dhe u ringjall përsëri?”

Me qëllim që ju ose kushdo tjetër të mund t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje, duhet të merrni në konsideratë fjalët që u tha Jezusi dishepujve: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta. Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje” (Gjoni 14:6). Apostulli Pjetër e theksoi deklaratën e guximshme të Mësuesit të Tij, kur tha: “Jezusi është [Mesia].... Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe më anë të të cilit duhet të shpëtohem (Veprat 4:11-12).

Jezusi thotë që Ai është e vetmja rrugë për një marrëdhënie me Perëndinë Atë. Arsyeja pse marrëdhënia jonë me Perëndinë ka nevojë të

ndreqet, është për shkak të mëkatit. Sipas Romakëve 3:23, të gjithë - që përfshin *secilin nga ne* - nuk i përmbushin standardet e përsosura morale të Perëndisë. Si rezultat, ne jemi të ndarë nga një Perëndi i shenjtë dhe duhet të mbartim dënimin për mëkatin tonë, i cili është ndarje e përjetshme nga Perëndia. Megjithatë, e vërteta e mrekullueshme e ungjillit është që ne mund të kemi paqe me Perëndinë nëpërmjet pendimit për mëkatin tonë dhe vendosjes së besimit në Jezu Krishtin (Romakëve 5:1). Kush do të ishte aq i pamend sa të refuzonte faljen e mëkateve dhe marrëdhënien e përjetshme me Perëndinë që ofron Jezusi, në bazë të provave të shumta për ringjalljen e Krishtit?

Krishti është i gjallë! Ai jeton sot! Përgjigjja më e logjikshme ndaj këtij realiteti është t'i besosh Jezu Krishtit me jetën tënde dhe të përjetosh transformimin personal që vetëm Ai mund ta sjellë.

Si mund t'i përgjigjesh asaj që ka bërë Jezusi për ty?

Ti mund t'i përgjigjesh personalisht asaj që ka bërë Jezusi për ty nëpërmjet vdekjes dhe ringjalljes së Tij, duke u lutur. Lutja është bisedë me Perëndinë. Perëndia të njeh zemrën dhe nuk i interesojnë aq shumë fjalët e tua, por i intereson qëndrimi i zemrës tënde. Nëse asnjëherë nuk e ke vendosur besimin tënd te Krishti, mund ta bësh këtë tani, duke u lutur me lutjen e mëposhtme:

Zot Jezu, kam nevojë për ty. Falemnderit që vdiqe në kryq për mëkatet e mia. Unë e hap derën e zemrës sime dhe të pranoj Ty si Shpëtimtar dhe Zot. Falemnderit që m'i fale mëkatet dhe më dhe jetë të përjetshme. Ulu në fronin e jetës sime dhe merr kontrollin. Më bëj atë lloj personi që Ti do që unë të jem.

A shpreh kjo lutje dëshirën e zemrës tënde? Nëse po, bëje këtë lutje tani, dhe Krishti do të vijë në jetën tënde, siç ka premtuar.

A je lutur për të pranuar Krishtin në jetën tënde? Atëherë, sipas premtimit të Tij te Zbulesa 3:20, ku është Krishti tani në marrëdhënie me ty? Krishti tha që Ai do të vinte në jetën tënde. A do të të mashtronte Ai? Jo! Mund të jesh i sigurt që Perëndia i është përgjigjur lutjes tënde, sepse Ai dhe Fjala e Tij janë të besueshme.

Bibla premtton që, duke pranuar Krishtin, ti do të kesh jetë të përjetshme: "Dhe dëshmia është kjo: Perëndia na dha jetën e përjetshme dhe kjo jetë është në Birin e Tij. Ai që ka Birin, ka jetën; ai që nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën. Jua shkrova këto gjëra juve që besoni në emrin e Birit

RINGJALLJA DHE TI

të Perëndisë, që të dini se keni jetën e përjetshme dhe që të besoni në emrin e Birit të Perëndisë” (1 Gjonit 5:11-13).

Falëndero Perëndinë tani që Krishti është në jetën tënde dhe që Ai kurrë nuk do të të braktisë (Hebrenjve 13:5). Mund ta dish, sipas premtimit të Tij, që Krishti jeton në ty dhe që ti ke marrë jetën e përjetshme që nga momenti që e ftove Atë të vinte në jetën tënde. Ai nuk do të të mashtrojë.

Si mund të rritesh në besimin tënd?

Ti nuk je krijuar për ta jetuar jetën e krishterë vetëm. Fjala e Perëndisë të nxit të takohesh me të krishterë të tjerë, që të rritesh dhe të qëndrosh i fortë (Hebrenjve 10:25). Disa drurë bëjnë më shumë flakë kur digjen së bashku; por lëre njërin mënjanë në vatrën e ftohtë të oxhakut dhe zjarri do të shuhet. Kështu është me marrëdhëniet e tua me të krishterë të tjerë. Nëse nuk je pjesë e një kishe, mos prit të të ftojnë. Merre iniciativën. Telefoni pastorit të një kishe që ke afër, ku nderohet Krishti dhe mësohet Fjala e Tij. Fillo këtë javë dhe planifiko të shkosh rregullisht.

Nëse ke vendosur një marrëdhënie me Perëndinë nëpërmjet Krishtit, ndërsa po lexon këto faqe, të lutem na shkruaj dhe na trego për këtë.

Instituti “Jeta e Re”

Email: info@ijr.al

Facebook: [Levizja IJR](https://www.facebook.com/LevizjaIJR).

Ne do të ishim shumë të gëzuar t’ju dërgonim disa materiale që do t’ju ndihmojnë në udhëtimin tuaj me Perëndinë në vijim. Gjithashtu, mund të lidheni me ne edhe nëpërmjet faqeve tona përkatëse të internetit: www.josh.org dhe www.seanmcdowell.org dhe www.ijr.al.

Në faqet tona të internetit do të gjeni shumë materiale të dobishme, si video, artikuj, libra dhe materiale të tjera, që do t’ju ndihmojnë në udhëtimin tuaj.

Le të sjellë ky libër, dhe vendimi juaj për t’i besuar Krishtit, një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si jetoni, si rezultat i marrëdhënies suaj të re me Jezusin.

XHOSH D. MEK-DAUELL
SHON Xh. MEK-DAUELL

Shënime

Kapitulli 1 Pse ka rëndësi ringjallja

1. "SuperNinjette," mesazh i postuar te www.atheistnetwork.com, July 16, 2007.
2. "Gjithë mundimet e epokave, gjithë përkushtimi, gjithë frymëzimi, gjithë shkëlqimi i fortë i gjenisë njerëzore janë të destinuara të zhduken... që i gjithë tempulli i arritjeve të njeriut të groposet në mënyrë të pashmangshme... Vetëm brenda tribunës së këtyre të vërtetave, vetëm mbi themelin e fortë *humbjes së sigurt të çdo shprese*, mund të ndërtohet me siguri banesa e shpirtit." Bertrand Russell, *A Free Man's Worship* (n.p., 1903). (Përkthimet këtu janë të redaktorit.)*
3. N. T. Wright, *The Challenge of Jesus* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1999), 126.
4. Këto pika janë zhvilluar te Stephen T. Davis, *Risen Indeed* (Grand Rapids: Eerdmans, 1993), 203-4.
5. Isaac Asimov, siç citohet nga Randy Alcorn, *Heaven* (Carol Stream, IL: Tyndale, 2004), 393.
6. Alcorn, *Heaven*, 242.

Kapitulli 2 A mund ta dimë se ringjallja ka ndodhur?

1. Craig Blomberg, *The Historical Reliability of the Gospels* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1987), 73.
2. Ross Clifford, *Leading Lawyers' Case for the Resurrection* (Edmonton, Alberta: Canadian Institute for Law, Theology & Public Policy, 1996), 104-5, theksimet të shtuara.
3. Blomberg, *The Historical Reliability of the Gospels*, 75-76.

4. Norman L. Geisler, *Miracles and Modern Thought* (Grand Rapids: Zondervan, 1982), 58.
5. Ronald Sider, "A Case for Easter," *HIS* (April 1972), 27-31.
6. Louis Gottschalk, *Understanding History*, 2nd ed. (New York: Knopf, 1969), 150.
7. Sean McDowell, *The Fate of the Apostles* (Farnham, UK: Ashgate Press, 2015).
8. Për më tepër hollësi për seriozitetin e dorëshkrimeve të Dhiatës së Re, shihni librin tonë *Evidence that Demands a Verdict: Lifechanging Truth for a Skeptical World* (Grand Rapids: Baker Books, forthcoming fall 2017).
9. John Wenham, *Easter Enigma* (Oxford, UK: Paternoster Press, 1984), 10-11.
10. Për më tepër shihni edhe *Jesus Christ: The Greatest Life Ever Lived*, plotësuar dhe përkthyer nga Johnston M. Cheney dhe Stanley Ellisen (Eugene, OR: Paradise Publishing, 1994) një rishikim i *The Life of the Christ in Stereo* (Portland, OR: Western Baptist Seminary Press, 1969).
11. Stephen T. Davies, *Risen Indeed* (Grand Rapids: Eerdmans, 1993), 69, emphasis added.
12. N. T. Wright, "The Transformation of the Bodily Resurrection," te *The Meaning of Jesus: Two Visions*, Marcus Borg dhe N. T. Wright (New York: Harper San Francisco, 2000), 121-22.
13. Paul Maier, *In the Fullness of Time: A Historian Looks at Christmas, Easter, and the Early Church* (Grand Rapids: Kregel, 1998), 180, theksimet janë shtuar.

Kapitulli 3 Provat për ringjalljen

1. Cicero, *V in Verrem*.
2. Dr. Alexander Metherell është intervistuar nga Lee Strobel te *The case for Christ* (Grand Rapids: Zondervan, 1998), 197-198.
3. William D. Edwards, Wesley J. Gabel, dhe Floyd E. Hosmer "On the Physical Death of Jesus Christ," *Journal of the American Medical Association* 255, no. 11 (March 21, 1986).
4. Michael Green, *Man Alive!* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1968), 33.
5. Gary R. Habermas, "Why I Believe the New Testament Is Historically Reliable," te *Why I Am a Christian: Leading Thinkers Explain Why They Believe*, ed. Norman L. Geisler dhe Paul K. Hoffman (Grand Rapids: Baker Books, 2001), 150.
6. Raymon E. Brown, *The Death of the Messiah*, vol. 2 (New York: Doubleday, 1994), 1240.

7. Will Durant, *Caesar and Christ* (New York: Simon & Schuster, 1944), 572.
8. John Chrysostom, *Homilies of St. John* (repr., Grand Rapids: Eerdmans, 1969), 321.
9. Rëndësia e ushtrisë romake është vënë në dukje nga Flavius Vegetius Renuat. Ai ishte një historian ushtarak që jetoi disa qindra vjet pas Krishtit. Në veprën e tij *Themeloret ushtarake të romakëve* (*The Military Institutes of the Romans*), Vegetius përshkruan sekretin e suksesit të ushtrisë romake: “Fitorja në luftë nuk varet e gjitha nga numrat apo guximi; atë e sigurojnë vetëm zotësia dhe disiplina. Na del se romakët ia detyrojnë... pushtimin e botës, askujt tjetër veç stërvitjes së vazhdueshme ushtarake, zbatimit me përkikmëri të disiplinës në kampet e tyre dhe moskultivimin e arteve të tjera të luftës.”
10. Archibald Thomas Robertson, *Word pictures in the New Testament*, 6 vols., (Nashville: Broadman Press, 1930), 1:238-239.
11. Paul Maier, “The Empty Tomb as History,” *Christianity Today*, March 28, 1975, 5.
12. George Currie, “The Military Discipline of the Romans from the founding of the City to the Close of the Republic” abstrakt i një teze botuar me mbështetjen e Graduate Council of Indiana University, 1928.
13. Bill White, *A Thing Incredible: A Reassessment of the Resurrection Narratives in Relation to Holy Week and Israel* (Israel: Yanetz Ltd., 1976).
14. Michael Green, *The Empty Cross of Jesus* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1984), 22-23.
15. Reginald H. Fuller, *The Foundations of the New Testament Christology* (New York: Scribner's, 1965), 142.
16. Hans von Campenhausen, “The Events of Easter and the Empty Tomb,” te *Tradition and Life in the Early Church* (Philadelphia: Fortress, 1968), 44.
17. C. H. Dodd, “The Appearance of the Risen Christ: A Study in Form-Criticism of the Gospels,” te *More New Testament Studies* (Manchester, UK: University of Manchester Press, 1968), 128.